



SHFK"Anton Zako Çajupi" f.Hotël

Plan global dhe aksionar për nxënësit me prirje dhe të talentuar

Shkenca natyrore

Klasa e tretë

Koncepti i ri

Viti shkollor 2023/24

Punoi: Mësimdhënësi, Zekirja Latifi

1

Rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programin mësimor shpijnë në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të mbuluara nga fusha Matematika dhe Shkencat natyrore nga Standardet Kombëtare:

Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund

III-A.28

të përdorë njohuritë themelore shkencore për të shpjeguar botën natyrore;

III-A.33

të hetojë dhe diskutojë ndikimin e shkencës, teknologjisë dhe aktiviteteve njerëzore në mjedis;

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

III-B.5

kurioziteti, sistematika dhe inovacioni (risitë) janë çelësi për zhvillimin e mendimit kërkimor shkencor;

III-B.8

çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në mjedisin e afërt dhe më gjerë dhe duhet të zhvillojë ndërgjegjësimin mjedisor dhe të veprojë në drejtim të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit.

Programi mësimor përfshin gjithashtu kompetencat përkatëse nga fushat e mëposhtme: Shkrim-leximi gjuhësor, Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike dhe Teknika, teknologjia dhe sipërmarrësia:

Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund

IV-A.2

të vlerësojë se kur dhe në çfarë mënyre nevojitet përdorimi efektiv i TIK-ut për të zgjidhur një detyrë/problem;

IV-A.5

të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet, për të gjetur, përzgjedhur dhe shkarkuar të dhëna digjitale, informacioni dhe përmbajtja;

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

IV-B.1

shkrim-leximi digjital është i nevojshëm për jetën e përditshme - lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim;

V- arritjet dhe mirëqenia individuale varen kryesisht nga përpjekja që bën dhe
B.3 rezultatet që ai/ajo i arrin;

Plan global për nxënësit e talentuar

Plan global për nxënësit me prirje dhe të talentuar	Kl.III-2	2023/24
Përgaditi;Arsimtari Zekirja Latifi	SHFK"Anton Zako Çajupi",f.Hotël	
Modifikoi:		
Fushat e nxënësve të talentuar dhe specifikat e tyre	Lënda Shkenca natyrore	
Aftësi specifike	Nxënësit e talentuar Posedojnë aftësi për lëmitë e caktuara hulumtuese,kanë memorje të mirë,janë të informuar nga më shumë lëmi,shpejtë përvehtësijnë dituri dhe shkathtësi,shpejt i zgjidhin problemet,shpejt i kuptojnë përmbajtjet e reja mësimore.	
Aftësi krijuese	Posedon kreativitet dhe pavrësia në marrjen e vendimeve;mendim fleksibil;ide autentike,të menduarit kritik dhe zgjidhjen e problemeve në mënyrë autentike.	
Aftësi të përgjithshme intelektuale	Posedon: shkallë e lartë e intelegjencës;fjalor të pasur,ide të reja,aftësi për abstaktim;mësimi lehtë i përmbajtjeve mësimore.	
Aftësi artistike	Posedon aftësi të kordinimit motorik,të shprehin ndjenja edhe për muzikën,aktrim,dhe vepra artistike.	
Shkathtësi sociale për udhëheqje	Nxënësit e talentuar marrin pergjegjësi mbi supet e tyre,kan aftësi të marrin vendime,kan pritshmëri të lartë dhe nga të tjerët.posedojnë tendencë për dominim.	
Shkathtësi informatike,teknologjike dhe mediatike	Tregojnë aftësi informatike,gjat punës në projekte duke përdorur Teknologjinë informatike komunikuese.	

Qëllimet	Përmbajtja	Koha e realizimit
-Identifikimi i nxënësve të talentuar përmes plotësimit të listave identifikuese; -Punimi i programeve individuale	Test me iniciale për kontrollimin e njohurive të lëndës së gjuhës shqipe ,dhe caktimi i nivelit të pëparimit.	shtator tetor prill qershor
-Individualizimi mësimi -Zbatimi i formave dhe metodave mësimore bashkëkohore.	Përdorimi i instrumenteve për përcjelljen e shkallës së të arriturave të nxënësve të talentuar.	nëntor dhjetor mars
-Përcaktimi i të arriturave individuale; -Pëmirësimi i të arriturave individuale të nxënësve të talentuar; -Pjesëmarrja në gara,konkurse dhe aktivitete hulumtuese	Pjesmarrja në gara eksterne dhe interne,në gara komunale,regjionale ose shtetërore,në gara të ndryshme të punës së aktiviteteve jashtëmësimore ose punës së dobishme shoqërore. Pjesmarrja në aktivitete ekologjike;përdorimi i teknologjisë informative komunikuese.	shtator dhjetor shkurt Mars qershor
<p>Rezultatet e pritura-efektet nga realizim i këtij program janë :Përkrahja e përpërimit të nxënësve me prirje dhe të talentuar ,pëmirësimi i qasjes për punë me nxënës me prirje dhe të talentuar ,mundësimin e përpërimit individual në pajtim me prirjen ose talentin ,zhvillimi i qëndrimit pozitiv të nxënësve me prirje dhe talent.</p>		

PROGRAMI PËR NXËNËSIT ME PRIRJE DHE TË TALENTUAR

Mësimdhënësi përmes punës së tij duhet ta njohë dhe ta motivoj zhvillimin individual të nxënësit dhe ta përkrah nxënësin e talentuar.

Faza e parë në punën me nxënës të talentuar është identifikimi i tyre përmes plotësimit të fletave identifikuese.

-Faza e dytë është identifikim i tipit të nxënësit të talentuar.

-Faza e tretë është përpunimi i programeve individuale.

-Faza e katërt është faza e realizimit.

Theksi në programin e punës me nxënës të talentuar duhet të koncentrohet në bazë të methodsve dhe formave të punës mësimore të cilat duhet të orientohen drejt mësimin të pavarur dhe shfrytëzimit të informacioneve, zhvillimit të aftësive, zgjedhja e metodave në koherencë me standardet nacionale, në atë mënyrë që të arrijë deri në rekordet e reja. Programi do të realizohet përmes;

- Individulizimit të mësimin me nxënësit
- Mësimi grupor i nxënësve me aftësi të përafërta, në orët e rregullta dhe në mësimin plotësues.
- Përmes aktiviteteve projektuese projektuese
- Organizimi i garave ,konkurseve dhe aktiviteteve hulumtuese;
- Organizimi i punëtorive kreative.

Qëllimet;

-Të njihen dhe identifikohen nxënësit sipas talentit të tyre;

-Të zbulohen karakteristikat e nxënësve të talentuar;

-Punë praktike me nxënësit e talentuar dhe orientimi i tyre profesional;

-Përcjellja dhe përparimi i personalitetit të nxënësit;

-Të nxitet motivimi i nxënësve;

-Dhënja e këshillave të prindërve të nxënësve të talentuar;

-Zhvillimi i aftësive të nxënësve për një ose më shumë regjioneve, përmes zhvillimit të aftësive të tyre, intereseve, motivimi dhe teknika e mësimin;

-Pjesëmarrja në gara të ndryshme;

-Zhvillim i drejtë psikofizik i personalitetit të nxënësit

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: SKELETI, MUSKUJT DHE ORGANET E BRENDSHME

Nxënësi / nxënësja do të jetë i/e aftë të: 1. identifikojë praninë e një skeleti te njerëzit dhe shpjegon rolin e skeletit në mbrojtjen e organeve të brendshme, sigurimin e mbështetjes dhe lëvizjes së trupit në hapësirë; 2. emërtojë dhe përshkruan eshtrat që përbëjnë skeletin e njeriut dhe krahason skeletin e njeriut me skeletin e kafshëve; 3. shpjegojë punën e muskujve dhe lidhjen e tyre me eshtrat gjatë lëvizjes dhe 4. përcaktojë vendndodhjen e trurit, zemrës, mushkërive, veshkave dhe lukthit në trup dhe shpjegon funksionin e tyre në mënyrë të thjeshtë.

Tema: *AVANCIMI I SHËNDETIT*

1. njeh dhe përshkruan sëmundjet më të shpeshta te fëmijët, simptomat dhe shkaqet e tyre,
2. lidh shëndetin me higjienën, ushqimin e shëndetshëm, aktivitetin fizik dhe forma të tjera të jetesës së shëndetshme,
3. shpjegojë se si njerëzit mbrohen nga sëmundjet infektive dhe nga përcjellja e sëmundjeve infektive.

Tema: FORCA DHE LËVIZJA

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. shpjegojë lëvizjen si një ndryshim në pozicionin e trupit dhe marrëdhënien midis shpejtësisë, distancës së përshkuar dhe kohës,
2. shpjegojë forcën si shkak të ndryshimit të lëvizjes dhe formës së trupave, fërkimin si forcë që ngadalëson lëvizjen, gravitetin si forcë me të cilën Toka tërheq trupat dhe efektet e veprimeve të forcave të ndryshme në të njëjtin trup;
3. dallojë makinat e thjeshta dhe komplekse dhe jep shembuj të përdorimit të tyre.

Tema: *NDRYSHIMET E MATERIALEVE*

1. përshkruajë disa ndryshime që mund të ndodhin në materiale dhe të dallojë ndryshimet në materiale që ndodhin nën veprimin e forcës dhe gjatë ngrohjes/ftohjes;
2. identifikojë ndryshimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të materialet dhe të shpjegojë ndryshimin midis tyre;
3. identifikojë djegien si një ndryshim të pakthyeshëm, njeh rrezikun e zjarreve dhe identifikon masat parandaluese dhe mbrojtëse.

Tema: *KOZMOSI (GJITHËSIA) DHE TRUPAT QIELLOR*

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. përshkruajë gjithësinë (Kozmosin) dhe yjet dhe njeh Diellin si yllin më të afërt me planetin Tokë,
2. bëjë dallimin midis yjeve dhe planetëve,

3. emërtojë planetët në sistemin diellor sipas largësisë së tyre nga dielli dhe i krahason në madhësi
4. numërojë dhe përshkruajë trupa të tjerë qiellorë, si satelitët, meteorët dhe kometat.

Plan global për nxënësit e talentuar

Temat kyçe që do të realizohen gjat vitit shkollor 2023/24

Plan global për nxënësit me prirje dhe të talentuar		Shkenca natyrore Kl.III-2	2023/24
Përgaditi;Arsimtari Zekirja Latifi		SHFK"Anton Zako Çajupi",f.Hotël	
Modifikoi:			
Përmbajtjet konceptet)	Standardet për vlerësim	Aktivitete	koha e realizimit
<ul style="list-style-type: none"> Skeleti (skeleti, njeriu, kafsha, eshtrat, kafka, brinjët, shtylla kurrizore, unazat, shpatulla, eshtrat e dorës, bërryli, nyjet, eshtrat e gishtave, eshtrat e shputës, nëngjuri, gjuri, femuri, kofsha) 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon praninë e një skeleti brenda trupit. Bën një krahasim midis skeletit të njeriut dhe skeletit të kafshës. 	Nxënësit ndjekin një paraqitje vizuale ose model të një skeleti, perceptojnë strukturën e skeletit të njeriut dhe emërtojnë kockat nga të cilat përbëhet (kafka, brinjët, shtylla kurrizore, unazat, qafa, shpatullat, eshtrat e krahut, bërryli, kyçi, kockat e gishtave, gishti i madh, kockat e këmbës, kyçi i këmbës, nëngjuri, gjuri, femuri, kofsha).	Shtator
Organet vitale (truri, zemra, mushkëritë, veshkat, lukthi)	Shpjegon funksionin e trurit, zemrës, mushkërive, veshkave dhe lukthit përmes një shembulli	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit ndjekin një prezantim vizual ose vëzhgojnë materialin e ilustruar të një skeleti të njeriut, peshku, bretkosa, hardhuca, pëllumbi, lepuri, lakuriqi, delfini dhe më pas diskutojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet që vënenë re. 	Nëntor
Kujdesi për shëndetin tuaj dhe shëndetin e të tjerëve (shëndet, mikroorganizma, viruse, baktere, simptomë, sëmundje, sëmundje infektive, vaksinim, kontrollim mjekësor, barna, farmaci, epidemi, pandemi)	Shpjegon konceptin e shëndetit përmes shembujve. <ul style="list-style-type: none"> Lidh shëndetin me rritjen dhe zhvillimin. Përshkruan se si një sëmundje infektive bartet nga një person i sëmurë te një person i shëndetshëm	Nëpërmjet teknikës "Stuhi idesh", nxënësit thonë asociacione të ndryshme për termin shëndet (p.sh. shëndet - ushqim i shëndetshëm, sport, gjumë, ajër i pastër, not, ecje etj.) dhe diskutojnë se çfarë duhet të bëjë një person për të qenë i shëndetshëm.	dhjetor

<ul style="list-style-type: none"> • Jetesë e shëndetshme (higjiena personale, higjiena e hapësirës, higjiena e ushqimit, ushqimi i shëndetshëm, pushimi, gjumi, aktiviteti fizik, dhëmbët e prishur, obeziteti, rakitizmi, dentist) 	<p>Shpjegon konceptin e higjienës përmes shembujve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lidh shëndetin me higjienën personale 	<ul style="list-style-type: none"> • Secili nxënës plotëson në mënyrë të pavarur një fletë pune në të cilën lidh një lloj ushqimi me një sëmundje specifike (p.sh.: mos konsumimi i qumështit dhe produkteve të qumështit me rakitizëm, konsumimi i pijeve të ëmbla dhe të gazuara me dhëmbë të prishur, konsumimi i ushqimeve të pasura me yndyra/usqimi i shpejtë dhe shfaqja e sëmundjeve të zemrës etj.). 	shkurt
<p>Ndryshimet në materiale (përdredhje, shtypje, shtrirje, tjetërsim, shkrije, ngrirje, e ngurtë, e lëngshme)</p>	<p>Përshkruan (me shembuj) ndryshimet e materialeve gjatë përdredhjes, shtypjes, shtrirjes dhe tjetërsimit që ndodhin me forcë.</p>	<p>Mësimdhënësi/ja demonstroi ndryshimet te materiale të caktuara nën ndikimin e forcës ose gjatë ngrohjes/ftohjes ku nxënësit vëzhgojnë dhe përshkruajnë ndryshimet e materialeve.</p>	mars
<p>Kozmosi (gjithësia)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Yjet (gjithësia / kozmosi, trupat qiellor, yjet, Dielli) 	<p>Përshkruan gjithësinë (Koymosin) dhe rendit llojet e trupave qiellorë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • I përshkruan yjet si trupa qiellorë me dritën dhe nxehtësinë e tyre. • Identifikon Diellin si yllin më të afërt me tokën. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit ndjekin një prezantim vizual rreth hapësirës dhe diskutojnë yjet si trupa qiellorë që rrezatojnë dritë dhe nxehtësi. Nxënësit në grupe të vogla, duke përdorur enciklopedi dhe/ose internet, hulumtoni karakteristikat e Diellit, duke kërkuar 	prill
<p>Trupa të tjerë qiellorë (satelitët, hëna, meteorët, kometat)</p>	<p>Identifikon satelitët, meteorët dhe kometat dhe përshkruan karakteristikat e tyre themelore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon Hënë si trupin qiellor më të afërt me Tokën dhe satelitin e saj të vetëm natyror. 	<p>Nxënësit shikojnë një prezantim vizual rreth Hënës dhe drejtojnë një diskutim rreth karakteristikave, pozicionit dhe lëvizjes së saj si satelit i Tokës.</p>	maj-qershor

Plan aksionar për nxënësit me prirje dhe të talentuar				
Përgaditi;Mësimdhënësi,Zekirja Latifi		SHFK"Anton Zako Çajupi",f.Hotël		
Modifikoi:		SHFK" "		
Nº	Aktivitetet	resurset/mjetet	Realizoi	koha e realizimit
1.	Informimi dhe njohja e arsimtarëve me prirjen dhe talentin;biseda me arsimtarë klasorë,udhëheqës arsimtarë lëndorë dhe prindër,zbatimi i instrumenteve për identifikim ,përgaditja e programeve individuale për punë me nxënës me prirja dhe të talentuar në aktivitetet jashtëmësimore,	Literaturë profesionale,prezentim e të ndryshme në nivel të ekipit professional. Ekipi për përgaditjen e planit vjetor në shkollë. Dhënia e instrumenteve për identifikim	Mësimdhënësi i klasor ekipi professional Prindër Nxënësit e talentuar	Shtator
2.	Identifikimi i nxënësve me prirje dhe të talentuar Përcjellja e programeve individuale për punë me nxënës me prirje dhe të talentuar.	Biseda konsultative profesionale të bazuara në materialin professional nga punëtorja e planifikuar	Mësimdhënësi i klasor Aktivi profesional	Tetor
3.	Dhënja e këshillave Punë konsultative me nxënës,prindër dhe arsimtarë.	Takimi dhe biseda me prindër;Resurse nga TIK,teste,ushtrime ,aktivitete	Arsimtarë klasorë Arsimtarë lëndorë	Nëntor
4.	Informimi i prindërve për nxënësit me prirje dhe të talentuar	Bisedë me nxënësit me prirje dhe të talentuar,literaturë profesionale -Dosie për nxënës me prirje dhe të talentuar	Bashkëpunëtorë profesional Nxënësit me prirje dhe të talentuar	dhjetor
5	Puna me nxënës me prirje dhe të talentuar	Resurse nga TIK ,Teste nga ndonjë pjesmarrje në gara komunale	Mësimdhënësi i klasorë	janar
6	Biseda këshilldhënëse me nxënësit me prirje dhe të	tabela e shpalljes,vebsajti i shkollës;aktivitete të	Aktiviti profesional	shkurt

	talentuar ,me qëllim të orientimit të drejtë,nxitjes dhe motivimit.	realizuara Brenda shkollës dhe jashtë shkollës	mësimdhënës i klasor	
7	Pjesëmarrje në manifestimet kulturore-shkencore si dhe në gara të ndryshme të gjuhës shqipe	Punë individuale dhe grupe me prindër dhe nxënës	Aktivi professional mësimdhënës i klasor	mars
8	Dallimi i rezultateve të arritura të nxënësve me prirje dhe të talentuar.	Aktivite interaktive teste,detyra kontrolluese si në programet kahoot,mentimeter,ëorldë ald etj.	Mësimdhënës i klasorë prindër figura eminente	prill
9	Lëvdrata,për arritjet e nxënësve me prirje dhe të talentuar.	Lëvdata diploma për aritjet në gara,të ndryshme	Mësimdhënës i klasor	maj-qershor